



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2, 61 dhe 67 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores nr. 1/2008, mbi Aerodromet, datë 27 nëntor 2008,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 4/2012
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 1/2008 MBI
AERODROMET**

Neni 1

Titulli i Rregullores Nr. 1/2008 ndryshohet në "Rregullore Nr. 1/2008 mbi Aerodromet e Certifikuara".

Neni 2

Neni 1, zëvendësohet si në vijim:

"Kjo Rregullore vlen për aerodromet duke i përfshirë heliportet, në dispozicion për shfrytëzim publik civil".

Neni 3

Në nenin 2, aplikohen ndryshimet në vijim:

Përkufizimi për "Aneksin 14" zëvendësohet si në vijim:

"Aneksi 14 - nënkupton Aneksin 14, Vëllimi I "Aerodromet" dhe Vëllimi II "Heliportet" i Konventës së Çikagos".

Shtohen përkufizimet vijuese për heliporte sipas rendit alfabetik:

“Heliport” nënkupton një aerodrom apo një zonë të caktuar në ndonjë strukturë që ka për qëllim të shfrytëzohet plotësisht apo pjesërisht për arritje , nisje dhe lëvizje të helikopterëve nëpër sipërfaqe.

Neni 4

Neni 4, paragrafi 1 zëvendësohet si në vijim:

“Operatori i aerodromit apo heliportit me trafik vjetor i cili tejkalon 10.000 pasagjerë në vit apo 850 lëvizje në lidhje me transportin e mallrave në vit, duhet të ketë në posedim certifikatën e aerodromit e cila lëshohet sipas kushteve të kësaj Rregulloreje”.

Neni 5

Neni 11, paragrafi 1, pika (b) ndryshohet si në vijim:

“Objektet dhe pajisjet e aerodromit, operimet apo mirëmbajtja e aerodromit nuk janë sipas standardit të kërkuar në interes të sigurisë së operimeve të fluturimit”.

Neni 6

Neni 21, paragrafi 2 zëvendësohet si në vijim:

“Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të siguroj që operimet dhe mirëmbajtja e aerodromit të zbatohen në një shkallë të arsyeshme për të ofruar operime të sigurta të fluturimit”.

Neni 7

Neni 27 pas paragrafit 1, shtohet paragrafi vijues:

27.2 Operatori i aerodromit duhet të njoftojë AAC-në paraprakisht për çfarëdo ndërtimi apo para çdo ndryshimi në karakteristikat fizike të aerodromeve të certifikuara të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrom, modifikimeve të mëdha në operime, përfshirë këtu edhe ngritjen e ndërtesave të reja dhe ndryshimet në ndërtesat ekzistuese apo në pajisjet vizuale.

Paragrafët pas paragrafit 2 ri-numërohen, ashtu që paragrafi 2 bëhet paragrafi 3 dhe kështu me radhë.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 tetor 2012.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm